

DEMOKRACIA NA PRANON ASHTU SIÇ JEMI




NE VENDOSIM

DRILON (12), ALBINA (12), YLLKA (12), AURITA (12), EMIR (12), AMER (12), SARA (12), RUVESA (12)

Ne, populli jemi ata që marrim vendime në demokraci. Prandaj, përgjegjësia na takon neve për mënyrën se si vendi ynë funksionon. Për më shumë, lexojeni artikullin më poshtë

Të jesh i lirë dhe t'i kesh të drejtat e barabarta është shumë e rëndësishme në jetë. Të gjithë qytetarët duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë pa dallim race, feje, gjinie, etj. Demokracia është pikërisht kjo formë e qeverisjes, ku populli ka të drejtat e barabarta. Qytetarët duhet të përkushtohen dhe të punojnë sa më shumë për të bërë ndryshime në vendin e tyre. Prandaj, secili prej nesh luan rol të rëndësishëm në shoqëri dhe në zhvillimin e saj.

Forma e parë e demokracisë u shfaq në vitin 507 para erës sonë në Athinë. Të drejtën e vendimmarrjes atë kohë, e kishin vetëm burrat e pasur. Kurse, gratë dhe të varfërit nuk e kishin atë të drejtë. Mirëpo, vendimet e marra nga burrat e pasur, zbatoheshin nga të gjithë. Në kohën e sotme të gjithë e kanë të drejtën e vendimmarrjes. Secili shtet demokratik ka përfaqësuesit të cilët i zgjedh vetë populli. Atyre demokracia ua mundëson për të votuar dhe për t'i zgjedhur përfaqësuesit, të cilët ata mendojnë se janë të denjë për atë punë. Edhe ne fëmijët kemi të drejtën e shkollimit dhe të drejtën të shprehemi lirshëm sepse shteti ynë na mundëson këtë. Ne edhe pse e kemi të drejtën e shkollimit duhet të jemi të përgjegjshëm dhe duhet të mësojmë shumë, sepse jemi ardhmëria e vendit tonë.



Të mësojmë së bashku për demokracinë



Grupi „Yjet janë këtu“



Ne e forcojmë demokracinë



Jemi të barabartë



Lumturia është mes nesh



Të jetosh me parimet e demokracisë

AKTIVIZIMI I QYTETARËVE NË DEMOKRACI

SUHELA (12), ERDETTA (12), ELMA (12), DION (12), ERIS (12), ARJON (12), FATLUM (12)



Ju ftojmë ta lexoni artikullin për qytetarët aktiv të lagjes „Blerim Durmishi“

Demokracia është shprehje e lirë e çdo qytetari. Në demokraci, qytetarët luajnë rol të rëndësishëm në udhëheqjen e vendit të tyre. Ata përmes votës së lirë zgjedhin përfaqësuesit e tyre. Qytetarët, të cilët e shfrytëzojnë të drejtën për votim quhen qytetarë aktiv.

Por, qytetarët aktiv nuk kufizohen vetëm në daljen e tyre për të votuar. Për të qenë qytetar aktiv mund të bësh shumë të mira për komunitetin ku jeton dhe vepron. Komuniteti ku jetojmë përfshin lagjen, shkollën, etj. Quhet komunitet për shkak se grupi i qytetarëve që bëjnë pjesë aty, kanë qëllime dhe interesa të përbashkëta. Ne do t'iu tregojmë një shembull të qytetarisë aktive në një lagje të Mitrovicës.

Në lagjen „Blerim Durmishi“, rruga ishte e paasfaltuar. Pas shumë kërkesave të qytetarëve të kësaj lagjeje tek organet komunale, u bë e mundur që udhëheqësi i Komunës sonë ta vizitojë këtë lagje. Pas bisedave me qytetarë të lagjes, Kryetari ishte bindur që është e

domosdoshme të asfaltohet rruga.

Ky është një shembull shumë i mirë për t'iu treguar se ne jetojmë në një shtet demokratik, ku respektohen kërkesat e qytetarëve. Gjithashtu, qytetarët me inicia-




tivat e tyre, kanë mundësi të bëjnë ndryshime në komunitetet e tyre duke ia shtuar vlerën atyre. Ne i inkurajojmë të gjithë qytetarët që të veprojnë si banorët e kësaj lagjeje, të cilët tani janë të kënaqur me veprimet që kanë ndërmarrë. Kështu mund të veprojmë të gjithë për të rregulluar jo vetëm lagjet, por edhe jetët tona.




Arjoni dhe Fatlumi duke e shkruar artikullin



Autorët e artikullit



Ne i zgjedhim deputetët në mënyrë që ata të flasin dhe të marrin vendime në emrin tonë. Këtë zgjedhje e bëjmë me anë të votës. Ky proces njihet si procesi zgjedhor



Në të kaluarën, gratë nuk kanë pasur të drejtë të marrin pjesë në procesin zgjedhor. Fatmirësisht dhe me shumë punë, gjërat kanë ndryshuar për të mirë. Sot gratë votojnë, sepse jemi të gjithë të barabartë




Bota e bukur e demokracisë



Gjinia nuk ka rëndësi në demokraci. Të gjithë kemi të drejta

VOTA, E DREJTA JONË E PËRBASHKËT

ERIS (12), ANES (12), LIZA (11), JONA (12), ALBENA (12), ARJANIT (12), YLLKA (11), URESA (12)



**Cili është procesi më i rëndësishëm demokratik?
Këtë përgjigje dhe shumë informata të tjera, i
gjeni në artikullin më poshtë**



Sot është hera e parë që unë si 18 vjeçare jam pjesëmarrëse në procesin zgjedhor. Jam shumë e vetëdijshme për rëndësinë që ka ky proces. Prandaj, edhe kam shikuar me vëmendje të plotë planprogramet e kandidatëve për kryetar të Komunës sime, Mitrovicës. Me shumë seriozitet dhe përkushtim, kam vendosur se kujt t'i a besoj votën time. Vlerat që unë kam kërkuar që kandidatët t'i kenë, janë: të jenë të drejtë, të jenë të sinqertë dhe të përmbushin të gjitha premtimet e dhëna. Për mua ka qenë shumë e rëndësishme që të kemi transport në të gjitha shkollat. Gjithashtu, të kemi parqe dhe hapësira të gjelbëruara.

Gjithmonë kam menduar, pjesëmarrja ime e parë në zgjedhje, a do të jetë në zgjedhjet parlamentare apo

në ato komunale? Dhe ja pra të dashur, unë jam duke marrë pjesë në zgjedhjet komunale dhe do të votoj për kryetarin e komunës dhe asambleistët.

Gjithashtu, unë mund të marrë pjesë edhe në zgjedhjet qendrore, ku mund të votoj kandidatët për deputetë. Duhet cekur se zgjedhjet e rregullta ndodhin çdo 4 vjet. Kjo e drejtë e imja, më bën mua shumë të lumtur. E gjitha kjo falë demokracisë.

Në demokraci, jemi ne qytetarët ata të cilët vendosim për të ardhmen e vendit tonë. Këtë e bëjmë përmes votës. E unë së bashku me grupin tim, ju ftojme të jeni qytetarë që e ngrisin zërin e tyre në vendimmarrje, përmes votës. Mendo me vend dhe zgjedh më të mirin për shtetin tënd. Ai person do të ndikojë në jetën tënde dhe gjithë qytetarëve të tjerë. Bëhu i vëmendshëm dhe zgjedh vetëm atë i cili e meriton votën tënde.



Autorët punëtorë të artikullit

DEPUTETËT JANË ZËRI I POPULLIT

ENEA (12), OLSA (12), ERDA (12), YLLKA (12), ARGJEND (12), ERONIT (12), ERON (12), MERIS (12)

Zëri i Popullit



Njoftohuni nga afër se kush e kishte rastin të luante rolin e deputetëve. Ishte vetëm një simulim, por më të vërtetë ndjenja që përjetuam ishte magjike

Si në çdo vend demokratik, qytetarët përpos të drejtave të tjera themelore, e gëzojnë edhe të drejtën e votës. Populli ynë ka të drejtën e të zgjedhurit lirshëm.

Zgjedhjet e fundit, në të cilat qytetarët e Kosovës kanë votuar janë zgjedhjet e 10 qershorit. Këto zgjedhje janë të njohura si zgjedhje qendrore, ku çdo qytetar mbi moshën 18 vjeçare ka gëzuar dhe gëzon të drejtën e votës. Kur themi çdo qytetar, mendojmë që nuk ka kufizime mes personave pavarësisht kushteve ekonomike, fesë, kombit, racës apo gjinisë. Në demokraci të gjithë e gëzojnë të drejtën e votës.

Në këto zgjedhje, unë Enea dhe shoqja ime Olsa kemi kandiduar për deputete. Përkrahja që qytetarët na ofronin ishte çelësi i suksesit tonë të sotëm. Ngase me anë të përkushtimit tonë, ne arritëm t'i fitojmë vo-

tat e qytetarëve.

Gjatë asaj kohe, ne të dyja kemi pasur çdo ditë takime me qytetarët, ku kemi dëgjuar brengat dhe shqetësimet e tyre. Ne iu kemi premtuar atyre se do të jemi zëri i tyre dhe secili prej qytetarëve do të ndjehet pjesë e vendimmarrjes. Ndër të tjera, ajo çfarë ne iu premtuam qytetarëve ishin mundësi më të mira shkollimi, sepse për ne arsimit është baza e demokracisë. Kur kemi edukatë sillemi më mirë dhe më drejt edhe me të tjerët.

Pas numërimit të votave, unë dhe shoqja ime u bëmë deputete. Nuk ka dyshim që u gëzuam, por po ashtu i kuptuam edhe përgjegjësitë tona, si: përfaqësimi i qytetarëve të Kosovë në mënyrën më të denjë, miratimi i ligjeve për të mirën e tyre, e shumë të tjera. Unë dhe Olsa kemi edhe shumë kolegë, të cilët gjithashtu janë votuar nga populli. Gjithsej jemi 120 deputetë, e të gjithë punojmë në të mirën e vendit. Mes nesh nuk ka dallime, ndonëse vijmë nga kombësi të ndryshme.



Duke ushtruar profesionin e gazetarit




Librat janë shumë të dashura për ne

Asnjë vend demokratik nuk mund të mendohet, nëse në krye të tij nuk është Kuvendi. Sepse Kuvendi është institucioni, i cili zgjedhet nga populli dhe punon për popullin

Kuvendi është një institucion i cili ka të drejtë dhe detyrë të miratoj ligjet për Republikën e Kosovës. Funkcionet e Kuvendit janë: të miratoj ligjet për të mirën e popullit, të përfaqësojë popullin e Kosovës dhe të kontrollojë punën e Qeverisë.

Në Kuvend janë të ulur 120 deputetë. Prej tyre 100 janë shqiptarë, kurse të tjerët janë nga komunitetet jo shumicë. Ndërsa, seancat plenare udhëhiqen nga Kryetari i Kuvendit dhe 5 nënkryetarët e tij.

Deputetët kanë të drejtë të bëjnë pyetje tek ministrat dhe ata duhen të përgjigjen ose me shkrim ose me gojë. Disa ligje, të cilat kanë ndikim në jetën tonë si nxënës janë: e drejta e të shprehurit lirshëm, e drejta e shkollimit, ajo e lojës, etj. Nëse do të isha unë deputet do të miratoja ligjin për përdorimin e uniformave në shkollë, në mënyrë që të mos dallohemi nga njëri-tjetri dhe të tregojmë që jemi të barabartë.




Të lumtur që mund të zgjedhim deputetët tanë



Autorët e zellshëm të këtyre dy artikujve



Kuvendi, pjesë e jona



Ligji i arsimit, ligj që ndikon në jetën tonë



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Abdullah Shabani“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VII-1
Website: www.demos-ti.org Vendi: Mitrovicë